



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 19.04.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18.03.2019 dhe 27.03.2019.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 12:08.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Medi Bici** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 5. Ilir Toska** (anëtar)
- 6. Alban Toro** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 8. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)

***Shënim:*** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Maksim Qoku*** dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Brunilda Kadi.***

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Marjana Papa, OSCE.*
7. *Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.*
8. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
9. *Helios Paveli, EURALIUS.*
10. *Rezart Alija, EURALIUS.*
11. *Alketa Vushaj, KSHH.*
12. *Erjon Fejzulla, USAID.*
13. *Klodian Rado, EURALIUS.*
14. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18.03.2019 dhe 27.03.2019.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Sikurse jeni njoftuar, po fillojmë mbledhjen e datës 19.

Në këtë mbledhje nuk janë prezent zoti Qoku dhe zonja Kadi, të cilët janë në angazhime profesionale, kështu që do vijojmë në mungesë të tyre. Këshilli e ka kuorumin për të vazhduar zhvillimin dhe vendimmarrjen e tij sipas rendit të ditës.

Sikurse jeni në vënë në dijeni me rendin e ditës, sot janë tre çështje për t'u diskutuar. Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datës 18.03.2019 dhe të datës 27.03.2019. Çështja e dytë është shqyrtimi i një projektvendimit "Për një shtesë në vendimin nr. 43, datë 12.03.2019 "Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës

së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve. Dhe çështja e tretë caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Dëshiroj t’ju bëj me dije se, paraprakisht, nga materialet që kemi shpërndarë dje për mbledhjen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka shtuar edhe disa...

Do e sqarosh vet! Okej!

Atëherë, jemi dakord me rendin e ditës.

Kalojmë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për datat përkatëse. Stafi, me sa kam dijeni, jua ka shpërndarë këto procesverbale. Nëse keni pasur komente lidhur me pasaktësi për këto?

Nuk keni!

Atëherë, e kalojmë për votim miratimin e procesverbaleve?

Po!

Kalohet për votim.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18 mars 2019 dhe 27 mars 2019. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 19.04.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.43, datë 12.03.2019 “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 12:08.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Medi Bici*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 5. Ilir Toska*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj*** (anëtar)

8. *Erjon Muharremaj* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti *Maksim Qoku* dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja *Brunilda Kadi*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Marjana Papa, OSCE.*
7. *Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.*
8. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
9. *Helios Paveli, EURALIUS.*
10. *Rezart Alija, EURALIUS.*
11. *Alketa Vushaj, KSHH.*
12. *Erjon Fejzulla, USAID.*
13. *Klodian Rado, EURALIUS.*
14. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.43, datë 12.03.2019 “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës.

Sikurse ju vura në dijeni, në çështjen e dytë është për diskutim dhe miratim një projektvendim për një shtesë në vendimin 43 mbi miratimin e listave emërore të kandidatëve për Ndhmës Ligjorë dhe për Këshilltarë Ligjorë. Për më shumë po ia lë fjalën relatorit të këtij projekt-akti, kryetarit të Komisionit përkatës, zotit Erjon Muharremaj.

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Bazuar në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me vendimin nr. nr. 43, datë 12.03.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi kandidatët që plotësonin kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për profilet e Ndhmësve Ligjorë dhe të Këshilltarëve Ligjorë.

Me shkresën me nr. prot. 1706/2, të datës 01.04.2019, një prej kandidatëve, shtetasi {...} i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor-së me arsyetimin se ka aplikuar pranë Shkollës së Magjistraturës edhe për pozicionin e Këshilltarit Ligjor, përveç atij të Ndhmësit Ligjor, ku ai në fakt figuronte si fitues për të marrë pjesë në provimin e formimit vetëm si Ndhmës Ligjor. Përpos kësaj, shtetasi {...} kërkon që të njihet si aplikant që plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e formimit edhe si Këshilltar Ligjor.

Nga verifikimi i dokumentacionit që na u përcoll nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën me nr. prot. 1706/3, të datës 09.04.2019 rezulton se shtetasi {...} ka plotësuar kriteret edhe për të marrë pjesë në provimin e formimit për Këshilltar Ligjor.

Në këto kushte, propozojmë që, vendimit nr. 43 t’i bëhet një amendim dhe në lidhjen 3 të tij, përveç listës emërore të kandidatëve, tashmë të shpallur si kandidatë që i plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e formimit, të shtohet edhe emri i kandidatit {...}, me nr. rendor 17.

Po lexoj propozimin për lidhjen 3 të përditësuar, ku të përfshihet edhe emri i shtetasit {...}, si vijon:

Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë Ligjorë (Lidhja nr. 3 e projektvendimit):

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};
11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...};
16. {...}dhe;
17. {...}.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi diskutime?

E hedhim për votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës?

Atëherë!

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.



*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të Komisionit përkatës.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 19.04.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 12:08.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ilir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Maksim Qoku** dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja **Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.**
4. **Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.**
5. **Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.**
6. **Marjana Papa, OSCE.**
7. **Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.**
8. **Klara Kodra, Qendra Evropiane.**
9. **Helios Paveli, EURALIUS.**
10. **Rezart Alija, EURALIUS.**
11. **Alketa Vushaj, KSHH.**
12. **Erjon Fejzulla, USAID.**
13. **Klodian Rado, EURALIUS.**
14. **Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës, e cila është lidhur me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme ku ushtrojnë funksionet...”.

Lidhur me procedurën e hedhjes së shortit, po ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, fillimisht ju bëj të ditur se për 4 gjykata (Gjykatën e Apelit Durrës, Vlorë dhe Gjirokastrë, si dhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin), ju është shpërndarë pak më parë relacionet e rishikuara, për shkak se ditën e djeshme, në Këshill kanë mbërritur disa kërkesa urgjente apo tepër urgjente. Konsideruam t'i përfshijmë në relacionet e përgatitura më herët, me qëllim që t'i evadojmë edhe këto kërkesat e paraqitura nga këto gjykata, referuar faktit të urgjencës së kërkesave të paraqitura.

Më tej, do t'ju propozoja radhën e shortit, ku është shpërndarë një material.

Kemi propozuar që radha e shortit të ndiqet në këtë mënyrë:

Fillimisht gjykatat e apeleve - Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm – Gjykata e Apelit Korçë, Apeli Gjirokastrë, Apeli Vlorë, Apeli Durrës dhe në fund Apelit Shkodër.

Më pas kemi propozuar që të vijojë shorti për gjykatat e shkallës së parë – fillimisht gjykatat me juridiksion të përgjithshëm sipas juridiksionit të apelit: fillimisht gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Më tej shorti të vijojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, fillimisht për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Më tej shorti të vijojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, fillimisht për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në fund për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Më tej shorti të vijojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më pas shorti të vazhdojë për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, fillimisht për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe më pas për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në fund, shorti të vijojë për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, në fund Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

Jeni dakord me këtë radhë shorti?

**Naureda Llagami:** E hedhim në votim.

Jeni dakord me radhën e shortit?

*(Anëtarët janë dakord.)*

Dakord që të gjithë. Vazhdojmë!

**Ilir Toska:** Mirë atëherë, vijojmë me procedurat e shortit për çdo gjykatë.

Atëherë do vazhdojmë me procedurat e shortit duke sjellë në vëmendjen tuaj se pse nuk mund të funksionojë skema e delegimit dhe ajo e transferimit. Në skemë delegimi nuk ka asnjë gjyqtar disponibël. Ndërkohë që sa i përket transferimit, konsiderohet i padobishëm referuar numrit të kufizuar për çështje për të gjitha gjykatat që kanë paraqitur kërkesë.

Po vazhdoj me shortin për **Gjykatën e Apelit Korçë**. Janë paraqitur kërkesa për 14 çështje. Kemi propozuar që Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Kemi propozuar që numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore, të jetë 10. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, vijojmë me procedurat konkrete të shortit.

Kemi propozuar që për 7 çështjet e para civile të caktohen 6 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë të përzgjedhur nga shorti i mëhershëm, gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga 6 gjyqtarët si më lart, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari përcakton edhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë, referuar trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton atë si relator të çështjes. Dakord?

Atëherë janë emrat e 6 gjyqtarëve që duhet të futen në një enë, ku do të përzgjidhet njëri prej tyre, i cili automatikisht do të përcaktojë treshen e trupit gjykues referuar përbërjes nga gjykata nga e cila vijnë.

Atëherë, i futëm në një enë emrat e 6 gjyqtarëve. Përzgjedhim njërin.

Atëherë, u përzgjedh gjyqtarja {...}.

Referuar përbërjes së trupave gjykues nga gjykata e cila vjen, ajo është në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtarët {...} dhe {...}. Pra 3 gjyqtarët që caktohen për çështjen nr. 3 janë {...}, {...} dhe {...}, ku gjyqtarja {...} është edhe relatores e çështjes.

Vijomë shortin për çështjet nr. 6 dhe nr. 7 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Si përzgjedhur me short konsiderojmë që të caktohen 3 gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët nuk janë përzgjedhur me short për çështjen nr. 3. Pra mbeten gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Në këtë rast shortin do ta zhvillojmë vetëm për përzgjedhjen e gjyqtarit relator, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për relator për çështjen nr. 6, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti caktohet si relator për çështjen nr. 7. Në opsionin që një nga 3 gjyqtarët në këtë rast është gjyqtarja {...}, e cila për çështjen nr. 6 ka pengesë, anëtari i trupit gjykues përzgjidhet me short ndërmjet 3 gjyqtarëve të përzgjedhur me short për çështjen nr. 3. Pra fillimisht të procedojmë për përzgjedhjen mes 3 gjyqtarëve {...}, {...}, {...}, se kush do të jetë relator për çështjen nr. 6 dhe nr. 7.

Atëherë, për çështjen nr. 6 u përzgjedh gjyqtarja {...} e cila ka pengesë ligjore. Duhet përzgjedhur me short nga 3 gjyqtarët... 3 gjyqtarët për çështjen nr. 6 dhe 7 janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. ... Për 6-ën është {...} relatores dhe për 7-ën është një tjetër, duhet të bëjmë short. Zgjidh një biletë tjetër – {...}.

Atëherë, për çështjen nr. 6, gjyqtarja {...} ka pengesë. Automatikisht, relator është gjyqtari {...} dhe për të formuar trupin gjykues për çështjen nr. 6 duhet të bëjmë një short tjetër, mes 3 gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...} – {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për çështjen nr. 6, ku relator është gjyqtari {...}, ndërkohë që për çështjen nr. 7 relatores është {...}, anëtarë janë {...} dhe {...}.

Vazhdojmë shortin për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë. Ata të përzgjidhen me short ndërmjet 3 gjyqtarëve që do të përzgjidhen me short për çështjen nr. 6 dhe nr. 7, pra ndërmjet 3 gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Do përzgjedhim 2 prej tyre.

Gjyqtari i parë është {...} dhe gjyqtari i dytë është {...}, të cilët caktohen për çështjen nr. 1.

Vijomë për çështjet nr. 2, 4 dhe 5 për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari. Ata të përzgjidhen me short ndërmjet 6 gjyqtarëve si më lart, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari, caktohet për çështjen nr. 2, ai i përzgjedhur i dyti, të caktohet për çështjen nr. 4 dhe ai i

përzgjedhur i treti, të caktohet për çështjen nr. 5. Atëherë, do të fusim në enë emrat e 6 gjyqtarëve {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, emri i parë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 2.

Emri i dytë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 4.

Emri i tretë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 5.

Vijojmë më tej shortin për çështjen e fundit civile, atë me nr. 8, për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari. Gjyqtari të caktohet nga Gjykata e Apelit Vlorë, ku duke konsideruar shortin e mëhershëm për formimin e trupit gjykues për këtë çështje, për të cilën janë caktuar gjyqtarët {...} dhe {...}, si i përzgjedhur me short konsiderohet gjyqtari që është në përbërje të trupit gjykues me këta dy gjyqtarë në gjykatën nga e cila vijnë. Referuar informacionit të marrë nga Gjykata e Apelit Vlorë, në përbërje të trupit gjykues, bashkë me gjyqtarin {...} dhe {...}, është gjyqtari {...}, i cili caktohet për çështjen civile nr. 8.

Vijojmë me shortin për 7 çështje penale, të caktohen 3 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër të përzgjedhur nga shorti i mëhershëm, gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, për çështjen nr. 11, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, shorti të zhvillohet vetëm për përzgjedhjen e gjyqtarit relator, ku ai i përzgjedhur i pari, caktohet si relator i çështjes. Të fusim në një enë emrat e 3 gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Atëherë, si relatore për çështjen nr. 11 është gjyqtarja {...}. Ndërkohë, dy gjyqtarët e tjerë {...} dhe {...} caktohen për çështjet 13 dhe 14 për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve.

Vijojmë për çështjet nr. 9, nr. 10 dhe nr. 12 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve si më lart, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për çështjen nr. 9, ai i përzgjedhur i dyti caktohet për çështjen nr. 10 dhe ai që mbetet, caktohet për çështjen nr. 12. Do fusim përsëri në enë emrat e 3 gjyqtarëve, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, për çështjen nr. 9 përzgjidhet gjyqtari {...}.

Për çështjen nr. 10 përzgjidhet gjyqtari {...}.

Dhe gjyqtari që mbetet, {...} caktohet për çështjen nr. 12.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vijojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojën për 7 çështje gjyqësore. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë minimalisht 6. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, vijojmë shortin për 4 çështjet e para, ato nr. 1, 2, 3 dhe 4 për të cilat kemi propozuar të caktohen 3 gjyqtarë të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe konkretisht duhet të fusim emrat e 4 gjyqtarëve të apelit Korçë. Në një enë futen emrat e 4 gjyqtarëve të apelit Korçë. Gjyqtari që do përzgjidhet i pari caktohet si relator për çështjen nr. 2, ai i përzgjedhur i dyti caktohet edhe relator për... do përzgjidhen njëherë emrat e 3 gjyqtarëve dhe automatikisht ai i përzgjedhur i pari është relator për çështjen 2, ai i përzgjedhur i dyti është relator për çështjen 3 dhe ai i përzgjedhur i treti caktohet për çështjen nr. 1 (jo relator).

Emri i parë është gjyqtari {...} i cili është në përbërje të trupit gjykues për 4 çështjet civile 1, 2, 3, 4, ndërkohë është edhe relator për çështjen nr. 2. Emri i dytë i përzgjedhur është {...} e cila është relatores për çështjen nr. 3, ndërsa është në përbërje të trupit gjykues për çështjet nr. 1, 2, 3 dhe 4. Ndërkohë, emri i tretë i përzgjedhur është {...}, i cili caktohet për çështjen nr. 1. Për çështjen nr. 4 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të përzgjedhur më lart – {...} dhe {...}.

Për dy çështjet e tjera civile, ato me nr. 5 dhe 6 caktohen 3 gjyqtarë të cilët përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, ku përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton edhe përzgjedhjen e 2 gjyqtarëve të tjerë referuar trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë e përcakton atë si relator për çështjen nr. 5. Më pas shorti vazhdon për përcaktimin e gjyqtarit relator për çështjen nr. 6, duke u përzgjedhur ai me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar si anëtarë në çështjen nr. 5. Atëherë, duhet të fusim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Emri i parë është {...}, i cili caktohet në përbërje të trupit gjykues për çështjen nr. 5 dhe nr. 6, ndërkohë që për çështjen nr. 5 është edhe relator.



Po vazhdojmë shortin.

Emri i dytë është – {...}, është e përjashtuar nga shorti se është anëtare e KED-së. {...} është emri i dytë i përzgjedhur, e cila caktohet si relatore për çështjen nr. 6. Vazhdojmë edhe për përzgjedhjen e emrit të tretë që do të formojë trupat gjykues... Një minutë, të lutem.

Kemi thënë që çështja nr. 5 dhe nr. 6, emri i përzgjedhur i pari përcakton edhe përbërjen e trupave gjykues. Emri i përzgjedhur i pari është emri i gjyqtarit {...}. Automatikisht shkojnë dy gjyqtarët që janë në përbërjen e trupit gjykues me gjyqtarin {...}, që janë {...} dhe {...}.

Pra 3 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë të përzgjedhur për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për çështjen nr. 5 dhe nr. 6, janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Për çështjen nr. 5, gjyqtar relator është gjyqtari {...}. Do hedhim short mes gjyqtarit {...} dhe {...} për përzgjedhjen si relator për çështjen nr. 6. Atëherë, gjyqtari relator për çështjen nr. 6 është gjyqtari {...}. Me kaq mbyllet shorti për çështjen nr. 5 dhe nr. 6.

Dhe çështja e fundit është çështja nr. 7, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Referuar informacionit të marrë nga kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari i përzgjedhur më herët për gjykimin e çështjes në themel, gjyqtari {...} (çështja është për lëshim urdhri ekzekutimi). Do duhet të zhvillojmë short vetëm për caktimin edhe të një gjyqtari të dytë, ndërsa një gjyqtar është në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, i cili të formojë trupin gjykues. Gjyqtari i dytë duhet të përzgjidhet mes dy anëtarëve të trupit gjykues, mes gjyqtarëve {...} dhe {...}. Atëherë, {...} caktohet krahas gjyqtarit {...} për çështjen nr. 7. Këtu përfundon shorti për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojën për 4 çështje (2 civile dhe 2 penale). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, vazhdojmë shortin. Nga shorti përjashtohen gjyqtarët {...} që është anëtar i KED-së dhe kryetarja në detyrë {...}. Viojmë shortin për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cila kërkohen 2 gjyqtarë, të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari, caktohet edhe për çështjen nr. 1, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti, caktohet edhe për çështjen nr. 4. Në këtë rast, nëse i përzgjedhuri i pari është gjyqtari {...}, që ka pengesë ligjore për çështjen nr. 1, ai caktohet edhe për çështjen nr. 4, kurse ai i përzgjedhur i dyti, caktohet edhe për çështjen nr. 1. Po ashtu, nëse i përzgjedhuri i dyti është gjyqtare {...}, që ka pengës ligjore për çështjen nr. 4, ajo caktohet edhe për çështjen nr. 1, kurse ai i përzgjedhur i pari caktohet edhe për çështjen nr. 4. Pra në invers.

Vazhdojmë me shortin. I pari është përzgjedhur gjyqtari {...}. Ndërsa e dyta është gjyqtare {...}. Këta dy gjyqtarë caktohen për çështjen nr. 2 dhe 3. Ndërkohë që gjyqtari {...} caktohet edhe për çështjen nr. 1, ndërsa gjyqtare {...} caktohet edhe për çështjen nr. 4. Me kaq mbaron shorti për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë shortin për **Gjykatën e Apelit Durrës**. Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojë për 4 çështje penale, për 5 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti 3 gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Apelit Shkodër që i kemi caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Kemi konsideruar që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër, zoti {...}, meqenëse është në përbërje të trupit gjykues dhe nuk mund të ndajmë trupat gjykues në këtë rast sepse duhet t'i prishim të dy trupat gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës.

Atëherë, fusim në enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër që nuk kanë pengesë dhe nuk janë përjashtuar nga shorti.

Atëherë do të vijojmë shortin për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. Ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit

Shkodër, ku përzgjedhja e gjyqtarit të parë, përcakton edhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë, referuar trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë. Përzgjidhe një emër! – {...}. Atëherë për çështjen nr. 2 dhe nr. 3, në përbërje të trupit gjykues është {...}, si dhe dy gjyqtarët e tjerë që janë në përbërje të trupit gjykues e gjyqtaren {...}n e Gjykatën e Apelit Shkodër.

Ndërpresim shortin, sa të marrim informacionin për këtë.

*(Rifillillon mbledhja.)*

Për çështjen nr. 2 dhe nr. 3, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Gjyqtari që u përzgjedh i pari, pra gjyqtarja {...} është edhe relatore për çështjen nr. 2. Më tej do vazhdojmë shortin mes dy gjyqtarëve të tjerë, për të përcaktuar relatorin për çështjen nr. 3, pra mes gjyqtarëve {...} dhe {...}. Atëherë, përzgjidhet gjyqtare {...}, e cila caktohet si relatore për çështjen nr. 3.

Vijojmë shortin për çështjet nr. 1, 4 dhe 5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, i cili të përzgjidhet me short ndërmjet tre gjyqtarëve të përzgjedhur në çështjen si më lart, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për çështjen nr. 1 dhe ai i përzgjedhur i dyti, caktohet për çështjen nr. 4 dhe ai që mbetet caktohet për çështjen nr. 5. Atëherë, futen në një enë emrat e tre gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}.

Emri i parë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 1.

Emri i dytë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 4.

Dhe emri që mbetet është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 5.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë shortin për **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje civile, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Atëherë, në një enë do të fusim emrat e 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës dhe do të përzgjedhim 3 prej tyre, 1 prej tyre, i cili automatikisht përcakton edhe trupin gjykues, sikundër ai i përzgjedhur i pari është edhe relator i çështjes. Do përjashtohet vetëm kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}. Emrat e tjerë në një enë. Përzgjidhet emri i gjyqtarit {...}. Atëherë, referuar trupit gjykues të Gjykatës së Apelit

Durrës nga e cila vijnë, janë edhe gjyqtarët {...} dhe {...}. Ndërkohë gjyqtari {...} është edhe relator për çështjen e vetme në nevojë të Gjykatës së Apelit Shkodër. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, fillimisht të Gjykatës së Apelit Tiranë. E para është për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur nevojë për 13 çështje, 3 civile dhe 10 penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 13 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 3. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord! Mirë, vazhdojmë me procedurat e shortit për 3 çështjet civile. E para, ato me nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Të caktohet 1 gjyqtar i cili të përzgjidhet me short mes 3 gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë përzgjedhur më herët për të gjykuar çështjet gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Më herët janë gjykuar me 1 ose me 2 çështje, prandaj propozojmë që të rikonsiderohet si të përzgjedhur me short po këta 3 gjyqtarë, për t'u shpërndarë edhe 3 çështjet, secilit nga 1 çështje. Jeni dakord?

Atëherë, hedhim në një enë emrat e 3 gjyqtarëve, {...}, {...} dhe {...} dhe shorti në këtë rast do konsistojë në shpërndarjen e 3 çështjeve, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari përcaktohet për çështjen nr. 1, ai i përzgjedhur i dyti, për çështjen nr. 2 dhe ai i përzgjedhur i treti, për çështjen nr. 3. Pra emrat e gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, emri i parë i përzgjedhur është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 1. Emri i dytë është {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 2. Dhe emri i tretë është emri i gjyqtarës {...}, e cila caktohet për çështjen nr. 3.

Vijojmë shortin për 10 çështjet penale, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen përmes shortit nga gjyqtarët e seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku me synimin për shpërndarjen e barabartë të çështjeve mes tyre, gjyqtari i

përzgjedhur i pari të caktohet për 5 çështjet penale, për 5 çështjet e para, ato 4, 5, 6, 7, 8 dhe gjyqtari i përzgjedhur i dyti, për çështjet e tjera. Prit të jemi korrekt me numrat.

Atëherë, do përjashtohen nga shorti gjyqtarët {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, të cilët janë gjykuar më herët në gjykatat e tjera, në dy shortet e mëparshme. Atëherë, emri i parë është {...}, i cili caktohet për 5 çështjet e para penale. Dhe emri i dytë është... Atëherë, anulohet shorti. Nuk janë korrekt emrat që janë futur në short. Emrat e seksionit penal për çështjet penale të themelit janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, dhe {...}. Do përjashtojmë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Okej, u bënë gati. Vazhdojmë me shortin!

Emri i përzgjedhur i pari është {...}, që është për 5 çështjet e para penale dhe emri i përzgjedhur i dyti është {...}, që është për 5 çështjet e dyta penale. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**, që ka nevojë për 4 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 1. Në këtë rast kemi propozuar të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që janë caktuar më herët dhe ata që u caktuan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, pra gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, përjashtohen. Emrat e tjerë të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë futen në një enë për të përzgjedhur njërin prej tyre, që do të gjykojë të katër çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Përzgjidhet gjyqtari {...}, i cili caktohet për të katër çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**, që ka paraqitur nevojë për 4 çështje penale, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short, nga duhet të caktohen, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2 (*ripërsëritet e njëjta fjali nga zoti Toska*). Jeni dakord?

Atëherë, duhet të bëjmë shortin mes gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për dy çështjet e para, ato me nr. 1 dhe nr. 2, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti, caktohet për dy çështjet e tjera, 3-shin dhe 4-ën.

Emri i parë i përzgjedhur është gjyqtarja {...}, që caktohet për çështjen nr. 1 dhe nr. 2. Emri i dytë është {...}, që caktohet për çështjen 3 dhe 4. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë nën juridiksionin e apelit Shkodër, fillimisht me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës**. Ka paraqitur nevojë për 2 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 1.

Atëherë, duhet të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Tropojë dhe të përzgjedhim njërin prej tyre – {...}. Pra gjyqtari {...} caktohet për 2 çështjet penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Me kaq mbyllet shorti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë**, që ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje penale. Kemi propozuar që gjyqtari të caktohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe të jetë një i tillë.

Atëherë, në një enë do të fusim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Atëherë është përzgjedhur emri i gjyqtarës {...}, e cila caktohet për një çështje gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Vazhdojmë me gjykatat e juridiksionit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, fillimisht me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, e cila ka paraqitur nevojë vetëm për një çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Jemi dakord?

Vazhdojmë me shortin.

Mirë atëherë, referuar faktit të numrit të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, gjyqtarëve që janë me leje dhe një gjyqtar i transferuar, gjyqtari që mbetet të caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është gjyqtari {...}.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë**. Ka paraqitur nevojë për 4 çështje (3 civile dhe 1 penale). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet të jetë 2. Jeni dakord? (Dakord).

Të 4 çështjet gjyqësore për të cilat kërkohet caktimi i gjyqtarëve, të caktohen 2 ose 3 gjyqtarë të cilët përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, ku me synimin për shpërndarjen e barabartë të çështjeve mes tyre, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet për dy çështjet e para, ato nr. 1 dhe nr. 2, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti, caktohet për dy çështjet e tjera, nr. 3 dhe nr. 4. Do fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Gjirokastrë dhe atë të Përmetit – {...}, caktohet për çështjet nr. 1 dhe nr. 2. {...}, caktohet për çështjet nr. 3 dhe nr. 4. Kemi vënë opsionin në rast se gjyqtari i përzgjedhur i dyti është gjyqtari {...} ose {...}. Atëherë, për çështjen nr. 4 do duhet të bëjmë përsëri short sepse gjyqtare {...} ka pengesë ligjore. Pra mbetet e caktuar për çështjen nr. 3 dhe për çështjen nr. 4 do duhet të bëjmë një short të ri – {...}. Pra gjyqtari {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet caktohet për çështjen nr. 4. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**, që ka paraqitur nevojë për 5 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ndërsa numri i gjyqtarëve të jetë 5. Jeni dakord?

Dakord! Mirë, vazhdojmë.

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit... Kemi propozuar tre gjykata për t'u caktuar: Gjirokastra, Saranda dhe Fieri. Për çështjen nr. 1 dhe nr. 5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Pra emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Gjirokastër, do përzgjedhim njërin prej tyre i cili është për çështjet nr. 1 dhe nr. 5 – {...}. Pra gjyqtari {...} caktohet për çështjet nr. 1 dhe nr. 5.

Vazhdojmë shortin për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, i përzgjedhur me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në këtë rast përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...}. {...} caktohet për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 (është bileta që është përzgjedhur nga shorti).

Vijojmë shortin për çështjen nr. 4, për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, që është çështje penale. Kemi propozuar që të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari është edhe relator i çështjes. Përjashtohet vetëm kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që është në seksion penal, {...} – {...}. Emri i dytë është {...}, emri i tretë është {...}. Gjyqtarja {...} është edhe relatores e çështjes. Me kaq mbyllet edhe shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vazhdojmë me gjykatën e juridiksionit të Gjykatës së Apelit Durrës që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë**, e cila ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje penale. Kemi propozuar që të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe gjyqtari të jetë 1, për aq sa është nevoja, ndërkohë që referuar informacionit të marrë nga kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, referuar faktit që më herët për çështjen ka qenë i caktuar gjyqtari {...} i seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kemi propozuar të mos bëhet short, por të konsiderohet shorti i mëhershëm dhe të caktohet gjyqtari {...} për gjykimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me gjykatat e juridiksionit të Gjykatës së Apelit Vlorë. Fillimisht me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë**, e cila ka paraqitur nevojën për 1 çështje penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Duhet të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke përjashtuar



kryetarin në detyrë, zotin {...}. {...} caktohet për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier**. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur nevojë për 1 çështje civile, ku kërkon caktimin e 1 gjyqtari. Kemi propozuar përsëri Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Edhe në këtë rast përjashtohet kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zoti {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë shortin atëherë.

{...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në një çështje civile. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin administrativ, fillimisht me **Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë**. Ka paraqitur nevojë për 3 çështje. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që duhet të caktohen për gjykimin e tre çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 2. Dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet 3 gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të përzgjedhur më parë me short (pra në shortin e datës 19.02.2019), pikërisht ndërmjet gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, do të fusim në një enë emrat e tre gjyqtarëve për të përzgjedhur 2 prej tyre. {...} është një nga gjyqtarët dhe {...} është gjyqtarja tjetër, të cilat caktohen të dyja për çështjen nr. 1.

Vazhdojmë shortin për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ai të përzgjidhet me short ndërmjet 3 gjyqtarëve si më lart, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari, caktohet për çështjen nr. 2, ndërsa gjyqtari i përzgjedhur i dyti, caktohet për çështjen nr. 3. {...} është emri i përzgjedhur i pari, i cili caktohet për

çështjen nr. 2. Dhe {...} është emri i përzgjedhur i dyti, e cila caktohet për çështjen nr. 3. Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Vazhdojmë me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila ka paraqitur nevojë për 3 çështje. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohen gjyqtarët për të gjykuar tre çështjet gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 1. Kemi konsideruar që të përjashtohen nga shorti të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë që janë caktuar më herët në shortet e mëparshme, që janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Këta duhet të përjashtohen, bashkë me kryetarin e gjykatës, zotin {...}. Do duhet të bëjmë short mes gjyqtarëve të tjerë për të përzgjedhur njërin prej tyre, i cili duhet të gjykojë të tre çështjet në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastrë. {...} është gjyqtarja e përzgjedhur, e cila duhet të gjykojë 3 çështjet në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Gjirokastrë. Me kaq mbyllet shorti për Gjykostrën.

Ngelet vetëm **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.** Kërkoheft caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar përsëri të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtari të jetë 1. Kemi konsideruar që të përjashtohen të gjithë gjyqtarët që janë caktuar më herët krahas gjyqtarit që u caktua për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Dhe ka mbetur vetëm 1 gjyqtar, që është {...}, e cila caktohet për të gjykuar 1 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Me kaq mbyllet edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe i gjithë shorti. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër për të shtuar, dëshiroj ta deklaroj mbledhjen të mbyllur. Mirupafshim! Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

